

BULETIN INFORMATIV



Zhvillimet në fushën e politikave dhe legjislacionit që garantojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara ● Korrik 2020 - Dhjetor 2020



Përmbajtja

- 1** Urdhër, nr. 381, datë 23.6.2020 “Për miratimin e protokollit për funksionimin e qendrave publike dhe jopublike, jorezidenciale, që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, gjatë dhe pas periudhës së fatkeqësisë natyrore, deri në përfundim të masave të distancimit fizik/social, për shkak të epidemisë covid-19
- 2** Udhëzimi i përbashkët nr. 22, datë 5.6.2020 “ Për mënyrën e ndërveprimit të programeve sociale të strehimit me shërbimet sociale të punësimit, arsimit dhe kujdesit shëndetësor”
- 3** Vendim nr. 535, datë 8.7.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”
- 4** Vendim nr. 558, datë 15.7.2020 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 325, datë 23.6.2000, të këshillit të ministrave, “Për krijimin e qendrës kombëtare ‘për mirëritjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijëve’, si njësi buxhetore, e veçantë”, të ndryshuar”.
- 5** Udhëzimi i përbashkët nr. 18, datë 1.7.2020 “ Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar”.
- 6** Urdhër nr. 434, datë 22.7.2020, “Për miratimin e përbërjes së komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, të nivelit të parë dhe epror, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara”.
- 7** Udhëzimi i përbashkët nr. 12, datë 21.7.2020 “Për përcaktimin e numrit të faqeve për të cilat informacioni përfitohet falas, rastet e përjashtimit nga pagesa e tarifës, si dhe rregulla për mënyrën e kryerjes së pagesës për pajisjen me informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”.
- 8** Vendim nr. 675, datë 2.9.2020, “Për një ndryshim në vendimin nr. 277, datë 18.6.1997, të këshillit të ministrave, “për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar”.
- 9** Vendim nr. 707, datë 9.9.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 182, datë 26.2.2020, të këshillit të ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”.
- 10** Vendim nr. 706, datë 9.9.2020, “Për miratimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit, 2020–2022, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij”.
- 11** Udhëzimi nr. 525, datë 18.9.2020, “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 2365, datë 26.11.2008 “mbi zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 ‘për përfitimet nga statusi i të verbrit’, i ndryshuar”.
- 12** Urdhër nr. 266/1, datë 1.9.2020, “Për marrjen e masave të veçanta nga komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga covid-19”.
- 13** Vendim nr. 783, datë 7.10.2020, “Për miratimin e planit të veprimit 2020–2022, në zbatim të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, 2015–2020”.
- 14** Vendim nr. 798, datë 12.10.2020, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 17, datë 15.1.2020, të këshillit të ministrave, “për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”
- 15** Vendim nr. 837, datë 28.10.2020, “Për procedurat, kriteret e rregullat për ofrimin e shërbimeve të punësimit”.
- 16** Ligj nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, “për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- 17** Ligj nr. 125/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.”.

URDHËR - Nr. 381, datë 23.6.2020

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT PËR FUNKSIONIMIN E QENDRAVE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE, JOREZIDENCIALE, QË OFROJNË SHËRBIME PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, GJATË DHE PAS PERIUDHËS SË FATKEQËSISË NATYRORE, DERI NË PËRFUNDIM TË MASAVE TË DISTANCIMIT FIZIK/SOCIAL, PËR SHKAK TË EPIDEMISË COVID-19

Ky urdhër ka dalë në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; të nenit 24, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; të pikës 6.1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, MSHMS, miraton “Protokollin për funksionimin e qendrave publike dhe jopublike, jorezidenciale, që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, gjatë dhe pas periudhës së fatkeqësisë natyrore, deri në përfundim të masave të distancimit fizik/social, për shkak të epidemisë COVID-19”. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen Shërbimi Social Shtetëror, qendrat publike dhe jopublike, jorezidenciale, që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, si dhe bashkitë. Ky udhëzim ka si qëllim të mbrojtë dhe të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara, të përfshihen në qasjen e re digjitale që ofrohet për të gjithë fëmijët në kushtet e fatkeqësisë natyrore, për arsye të epidemisë COVID-19.

Më konkretisht, ky udhëzim synon:

- të sigurojë vazhdimin e mbështetjes për fëmijët/të rinjtë me aftësi të kufizuara në kuadrin e zbatimit të “Standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat rezidenciale dhe ditore, të miratuara me vendim nr. 822, datë 6.12.2006” (më poshtë të quajtura “Standarde të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara”) dhe në përputhje me Manualin e Zbatimit të Standardeve të Shërbimeve për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara dhe në kushtet e fatkeqësisë natyrore”;
- të sigurojë ofrimin e mbështetjes psikosociale për prindërit e fëmijëve/të rinjve në përgjithësi dhe në veçanti, në kushtet e stresit të shtuar, për shkak të COVID-19 dhe masave shtrënguese shoqërore;
- të aftësojë ofruesit e shërbimeve në përdorimin e mekanizmeve të shërbimit online, shoqëruar me rregulla dhe kritere të qarta, për shërbimin e ofruar në këtë mënyrë;

- të rrisë përmes trajnimeve aftësinë e ofruesve të shërbimeve, për të ofruar mbështetje psikosociale për prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve/të rinjve me aftësi të kufizuara, për përballimin e stresit të shtuar;
- të ndërtojë një platformë pune, në përputhje me kërkesat e distancimit social/fizik, kur mbështetja online nuk është e mundur ose përfundon;
- të sigurojë respektimin e parimeve dhe të kërkesave, të:
- Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
- udhëzimet specifike të vazhdueshme të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, Institutit të Shëndetit Publik dhe OBSH-së për COVID-19;
- konsiderime për fëmijët e të rriturit me aftësi të kufizuara-përgjigje e UNICEF-it ndaj COVID-19 (COVID-19 response – UNICEF);
- mbështetje për fëmijët dhe për familjet përgjatë COVID-19 – Autizmi flet (Autism speaks);
- të mësuarit në distancim social – UNESCO;
- personat me aftësi të kufizuara dhe COVID-19 – QKS (CDC).

Objekt i udhëzimit janë shërbimet e ofruara nga të gjitha qendrat publike dhe jopublike komunitare/ditore/gjysmëditore/të zhvillimit/të specializuara, për fëmijët/të rinjtë me aftësi të kufizuara, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore dhe deri në përfundim të masave të marra për epideminë COVID-19, ku kërkohet distancim social/fizik. Ky udhëzim vendos rregulla, për:

- bashkitë, të cilat janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e punës së qendrave komunitare/ditore/gjysmëditore/të zhvillimit/të specializuara, në territorin e tyre;
- qendrat komunitare/ditore/gjysmëditore/të zhvillimit/ të specializuara për personat me aftësi të kufizuara dhe për personelin profesionist të tyre, për punën me personat me aftësi të kufizuara, mbështetjen psikosociale të prindërve e kujdestarëve të fëmijëve dhe bashkëpunimin me ta.

Lexoni të plotë në: <https://juristionline.al/wp-content/uploads/2020/12/urdher-2020-06-23-381.pdf>;

UDHËZIM I PËRBASHKËT - Nr. 22, datë 5.6.2020

PËR MËNYRËN E NDËRVEPRIMIT TË PROGRAMEVE SOCIALE TË STREHIMIT ME SHËRBIMET SOCIALE TË PUNËSIMIT, ARSIMIT DHE KUJDESIT SHËNDETËSOR

Ky udhëzim ka dalë në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 12 të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, ministri i Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë’ Ai udhëzon: njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmes strukturave të tyre përgjegjëse të strehimit, informojnë ministrinë përgjegjëse për strehimin, punësimin, arsimin dhe kujdesin shëndetësor dhe social, si dhe institucionet e tyre të varësisë, për listën e personave përfitues nga programet e strehimit social.

- 1 Njësitë e vetëqeverisjes vendore përdorin bazën e të dhënave në nivel vendor për strehimin social për këmbimin e informacioneve dhe mbajtjen e kontakteve me qëllim ndërveprimin gjatë zbatimit të programeve të strehimit social me ministrinë përgjegjëse për strehimin, punësimin, arsimin dhe kujdesin shëndetësor e social;
- 2 Strukturat përgjegjëse të ministrive për strehimin, punësimin, arsimin dhe kujdesin shëndetësor e social identifikojnë

nevojat për punësim, arsim, shërbime shëndetësore dhe sociale të personave që përfitojnë nga programet e strehimit social dhe ndjekin përmes strukturave përgjegjëse të administratës shtetërore adresimin e nevojave sipas fushave të përgjegjësisë.

- 3 Strukturat përgjegjëse të ministrive përgjegjëse për strehimin, punësimin, arsimin dhe kujdesin shëndetësor e social, në përputhje me programet e shërbimit sipas fushës së përgjegjësisë, përdorin bazën e të dhënave në nivel kombëtar dhe vendor për strehimin social, sipas qasjes që ata kanë në to në përputhje me legjislacionin në fuqi, për shërbimet për punësim, arsim dhe ato shëndetësore e sociale nga të cilat përfitojnë personat.

Udhëzimi përcakton në mënyrë specifike detyrimet edhe për personat me aftësi të kufizuara si përfitues nga programet e strehimit.

Lexoni udhëzimin të plotë në: <http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=5171&token=48e2446c5972ade45316a0ea09535c2974e6c8a4>

VENDIM - Nr. 535, datë 8.7.2020

PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËVE PUBLIKE NË KOMUNITET

Ky vendim është aprovuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimin”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave. Ky vendim përcakton procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet.

Programi i punëve publike në komunitet është një program 12-mujor, i cili ka qëllim përfshirjen në tregun e punës të punëkërkuarve të papunë afatgjatë, ku përfshihen edhe personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të mundësive të trajnimit dhe të punësimin me kohë të pjesshme në aktivitete me fokus shërbimet në dobi të komunitetit.

Fushat e veprimtarisë së programit të punëve publike në komunitet përfshijnë: a) shërbimet e kujdesit për fëmijët; b) shërbime të kujdesit shëndetësor dhe social; c) shërbime të rehabilitimit

të ish-përdoruesve të substancave narkotike; ç) punime dhe shërbime për komunitetin dhe mjedisin; d) shërbime këshillimi dhe informacioni; dh) shërbime rinore; e) sport; ë) art, turizëm dhe kulturë.

Programi i punëve publike në komunitet zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimin dhe Aftësive, më poshtë AKPA, në bashkëpunim me organizatat e përcaktuara në pikën 5, të kreut III, të këtij vendimi, nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e kësaj Agjencie, përfshirë aspektet financiare, ato të menaxhimit dhe të trajnimit.

Punëkërkuarët e papunë, pjesëmarrës në këtë program, angazhohen 20 orë në javë, gjatë 5 (pesë) ditëve të javës. Pjesën tjetër të ditës së punës punëkërkuarët e papunë pjesëmarrës mund të angazhohen në trajnime shtesë. Trajnimi kryhet në qendrat publike të formimit profesional ose në ato private të licencuara.



◀◀ MBËSHËTETJA E PËRFITUESVE

1. Punëdhënësi përfitues, sipas pikës 4, të kreut III, të këtij vendimi, përfiton një grant për të financuar: Për punëkërkesit e papunë, pjesëmarrës në program, financimet janë, si më poshtë vijon: a) Financim i pagës në shumën 50% të pagës minimale, në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. b) Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. c) Kupon për trajnim të punëkërkesve të papunë, pjesëmarrës në program, deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë, në rastet kur trajnimet e miratuara nuk ofrohen nga ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional. ç) Për përfituesit jetimë që përfitojnë nga ky status edhe pasi kanë kaluar moshën 25 vjeç, sipas legjislacionit në fuqi, prindër të vetëm me fëmijë nën 6 vjeç, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit, viktimat e dhunës në familje ose të dhunës me bazë gjinore, përfitues të ndihmës ekonomike, romë dhe egjiptianë mbulohej edhe shpenzime të tjera, si më poshtë vijon: i. bonus për shpenzimet e transportit mbulohej për të gjitha kategoritë e mësipërme, të cilët e kanë vendbanimin mbi 2 km nga vendi i punës, në vlerën prej 1 600 (një mijë e gjashtëqind) lekësh në muaj; ii. për prindërit e vetëm me fëmijë nën gjashtë vjeç, jepet bonus në vlerën prej 3 000 (tre mijë)

lekësh në muaj, për ndjekjen e kopshteve dhe të çerdheve, për çdo fëmijë në ngarkim; iii. financim deri në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë për një person, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë, nëse punëson më shumë se dy persona, për përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës, për personat me aftësi të kufizuara.

Për punëdhënësin, pjesëmarrës në program, financimet janë, si më poshtë vijon: a) Për mbikëqyrësin, financim të pagës në shumën: i. 50% të pagës mesatare në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për grupin nga 1–7 punëkërkes të papunë pjesëmarrës, për 20 orë në javë; ii. 100% të pagës mesatare në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për grupin nga 1–14 punëkërkes të papunë pjesëmarrës, për 40 orë në javë. b) Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës mesatare në shkallë vendi, të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. c) Tarifë për mbulimin e shpenzimeve materiale, të nevojshme për zbatimin e projekteve të punësimit në komunitet, në shumën totale deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo përfitues, këto të justifikuar me fatura tatimore, sipas legjislacionit në fuqi.

Për më tepër, lexoni vendimin të plotë këtu: <http://akpa.gov.al/wp-content/uploads/2020/08/VKM-Nr.535-date-08.07.2020.pdf>;

VENDIM - Nr. 558, datë 15.7.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 325, DATË 23.6.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E QENDRËS KOMBËTARE ‘PËR MIRËRRITJEN, ZHVILLIMIN DHE REHABILITIMIN E FËMIJËVE’, SI NJËSI BUXHETORE, E VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR

Ky vendim është marrë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për disa ndryshime dhe shtesa në lidhje me (a) ndryshimin e emërimit “Qendra Kombëtare ‘Për mirërritjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijëve’” me “Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët”. Përcaktohet në pikën 2.1 se Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët është institucion që ofron shërbime të shëndetit mendor, në lidhje me diagnostikimin, trajtimin, kujdesin terapeutik dhe rehabilitimin e aftësisë së kufizuar

për fëmijët. Në pikën 2.3 përcaktohet se shërbimet ofrohen nga ekipe multidisiplinare të përbëra nga specialistë të disa fushave, si: mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, terapistë okupacionalë, logopedistë, terapistë zhvillimi, ergoterapistë, fizioterapistë, terapistë psikomotorë dhe specialistë të tjerë të profilit mjekësor, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas roleve dhe përgjegjësi të përshtuara në rregulloren e brendshme të institucionit.

Të plotë vendimin e gjeni në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/07/15/558/32d4eb6a-df9f-4b4f-b9f4-bcd9ec757f4a>

UDHËZIMI I PËRBASHKËT - Nr. 18, datë 1.7.2020

PËR PROCEDURAT E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Ky udhëzim, në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 25 dhe 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të vendimit nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore, të sistemit të arsimit parauniversitar”; dhe të vendimit nr. 227, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”, në kreun II, “Përzgjedhja dhe porositja e teksteve shkollore”, pika 4 parashikon për nxënësit që gëzojnë statusin

e “të verbrit”, të cilët mësojnë në klasat I deri IX, pajisen me tekste shkollore specifike për këtë kategori të transkriptuara në shkrimin brail, të regjistruara në audio ose shkrim të zmadhuar. Këto tekste shkollore janë pronë e shkollës dhe afati i përdorimit të tyre është tre vjet ose më shumë, në varësi nga konsumi i tyre. Administrimi i kërkesave për prodhimin/shumëfishimin e këtyre teksteve, si dhe pajisja me libra e nxënësve të verbër realizohet nga Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë, në Tiranë. Drejtoritë përkatëse të shkollave ku mësojnë nxënës të verbër, duhet të dorëzojnë në ZVAP-të përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie, për çdo klasë të vitit pasardhës shkollor.

Lexoni të plotë vendimin: https://drive.google.com/file/d/1eLMgGFTSYJWNgbVV9ZCXGiGm6Ax9iQbO/view?fbclid=IwAR0knEb7KdfoJs65hpObKqgDG1sklP9zHrs-7IXNF_xHMzFYJGpYPX9DOX4

URDHËR - Nr. 434, datë 22.7.2020

PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE MJEKËSORE TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË, TË NIVELIT TË PARË DHE EPROR, PËR VLERËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Urdhri i dalë në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 4, pika 3, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, datë 18.7.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë; të nenit 15, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar; të pikave 2 dhe 7, të kreut II, të vendimit nr. 182, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave e dokumentacionit

për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”, miraton përbërjen e komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë (KMCA), të nivelit të parë, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara si edhe përbërjen e komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë (KMCA), epror, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara. Për më tepër lexoni të plotë urdhërin në:

<https://qbz.gov.al/eli/urdher/2021/01/18/23/6cec6f3c-36d2-48ffb3c2-0fc787c3cfb3>

UDHËZIM I PËRBASHKËT - Nr. 12, datë 21.7.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË FAQEVE PËR TË CILAT
INFORMACIONI PËRFITOHET FALAS, RASTET E PËRJASHTIMIT
NGA PAGESA E TARIFËS, SI DHE RREGULLA PËR MËNYRËN
E KRYERJES SË PAGESËS PËR PAJISJEN ME INFORMACION
QË PRODHOHET OSE MBAHET NGA AUTORITETET PUBLIKE**

Udhëzimi në mbështetje, të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 13 dhe të pikës 3, të nenit 16, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë, parashikon qw personat e regjistruar në skemat e ndihmës

shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, e përfitojnë informacionin dhe/ ose dokumentacionin pa pagesë deri në 20 fletë, për çdo kërkesë ose në vlerën ekuivalente kur informacioni jepet në një format tjetër, pas vërtetimit të statusit përkatës.

VENDIM - Nr. 675, datë 2.9.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 277,
DATË 18.6.1997, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT”, TË NDRYSHUAR**

Ky vendim i dalë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 17, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përcakton një ndryshim në fjalinë e parë të pikës 4, të vendimit nr. 277, datë

18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, si vijon: “Masa e përfitimit për shkak të verbërisë është 12 092 (dymbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) lekë në muaj dhe kjo masë indeksohet çdo vit nga Shërbimi Social Shtetëror, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit.”.

VENDIM - Nr. 707, datë 9.9.2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 182, DATË
26.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN
E MASËS, TË KRITEREVE, PROCEDURAVE E DOKUMENTACIONIT
PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E PAGESËS PËR PERSONAT ME
AFTËSI TË KUFIZUARA, SI DHE TË NDIHMËSIT PERSONAL”**

Ky vendim i dalë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 17, pika 1, të ligjit nr. 57, datë 18.7.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 15, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000,

“Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave, ka aprovuar Në kreun II ,pas pikës 1 shtohen pikat 1.1 dhe 1.2, me këtë përmbajtje:

“1.1. Personi që vlerësohet për herë të parë për aftësi të kufizuara, përveç vlerësimit të dosjes paraqitet edhe personalisht para KMCAP-së së nivelit të parë.

1.2. Rivlerësimi i personave me aftësi të kufizuara bëhet bazuar në dokumentacionin e dosjes së paraqitur, pa praninë fizike të personit me aftësi të kufizuara. Komisioni, në rastet kur nuk mund të marrë vendim vetëm bazuar në dokumentacionin e paraqitur për rivlerësim, ka të drejtë të thërrasë personin me aftësi të kufizuara për t'u paraqitur fizikisht në komision. Paraqitja në komision do

të bëhet në një nga mbledhjet e muajit pasardhës, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data që do të realizohet vlerësimi me dosje. Njoftimi formal për paraqitje në komision do të bëhet përmes administratorit shoqëror të njësisë administrative, nën juridiksionin e të cilit ka vendbanimin personi.” Pika 9 shfuqizohet.

Në fund të kreut II shtohet kreu II/I “Rregullat procedurale të vlerësimit nga KMCAP-ja”. Per me teper lexoni vendimin në: <https://kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-9-shtator-2020/>

VENDIM - Nr. 706, datë 9.9.2020

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË DEINSTITUCIONALIZIMIT, 2020–2022, DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E TIJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave, u miratua Planit Kombëtar i Deinstitutionalizimit, 2020–2022, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij.

Plani i veprimit të deinstitutionalizimit identifikon qëllimet dhe objektivat për realizimin e politikës - Deinstitutionalizimi, parandalimi dhe krijimi i shërbimeve alternative të fëmijëve të moshës 0–18 vjeç, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara.

Objektivi i parë strategjik është: Harmonizimi i sistemit të integruar ligjor, administrativ dhe procedural, që siguron zbatimin e interesit më të lartë të fëmijë;

Objektivi i dytë strategjik është: Shërbime sociale dhe të integruara

për ndërhyrje të hershme dhe parandalimin e ndarjes së fëmijës nga mjedisi familjar (përfshirë fëmijët me AK);

Objektivi i tretë strategjik është: Sigurimi i interesit më të lartë të fëmijëve (përfshirë fëmijët me AK) rezidentë në IPSH-të publike dhe Qendrat e Zhvillimit;

Objektivi i katërt strategjik është: Ngritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi i institucioneve dhe publikut të gjerë për mirëqenien e fëmijëve dhe deinstitutionalizimin;

Objektivi i pestë strategjik është: Koordinimi në nivel kombëtar dhe monitorimi i zbatimit të planit kombëtar të deinstitutionalizimit;

Për më tepër lexoni VKM të plotë në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/09/09/706/885bc461-97cb-4e62-9705-b265c8dcf1f7>

UDHËZIM - Nr. 525, datë 18.9.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 2365, DATË 26.11.2008 “MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 277, DATË 18.6.1997 ‘PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT’, I NDRYSHUAR”

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar dhe pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar, ky udhëzim ndryshon pikën 2/1 dhe 2.2 të udhëzimit të mëparshëm: “2.1. Administratori shoqëror, me marrjen e dokumentacionit

nga institucioni shëndetësor e dërgon atë brenda 24 orëve, me procesverbal/postë pranë Shërbimit Social Shtetëror. Mjeku i Shërbimit Social Shtetëror verifikon dosjet e paraqitura për vlerësim nëse janë të plotësuara me dokumentacionin përkatës dhe, më pas, i përcjell ato në KMPV. Personi që vlerësohet për herë të parë, përveç vlerësimit të dosjes paraqitet edhe personalisht para KMPV-së të nivelit të parë. 2.2. Rivlerësimi bëhet bazuar

• në dokumentacionin e dosjes së paraqitur, pa praninë fizike të individit. KMPV-ja në rastet kur nuk mund të marrë vendim vetëm bazuar në dokumentacionin e paraqitur për rivlerësim, ka të drejtë të thërrasë për t'u paraqitur fizikisht individin në komision. Paraqitja në KMPV do të bëhet në një nga mbledhjet e muajit pasardhës, por jo më vonë se 30 ditë nga data që do të realizohet vlerësimi me dosje. Njoftimi formal për paraqitje në KMPV do të bëhet përmes administratorit shoqëror të njësisë administrative, nën juridiksionin e të cilit ka vendbanimin personi.”.

Pika 16 e udhëzimit, paragrafi i parë ndryshon në: “Dokumentacioni i dosjes së përfituesit që është vlerësuar nga KMPV-ja, hidhet në arkivin elektronike brenda afateve dhe sipas rregullave të detajuara në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e komisioneve dhe më pas dërgohet pranë njësisë administrative së bashku me njoftimin për vendimin për çdo person.”.

Udhëzimin e gjeni në: <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2020/09/18/515/d5046735-0cdf-46f2-8987-a0373a1c6984>;

URDHËR - Nr. 266/1, datë 1.9.2020

PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NGA KOMISIONET E VLERËSIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE INVALIDËVE TË PUNËS PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Ky urdhër vendos që: 1. Komisionet mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të nivelit të parë dhe epror, të cilat funksionojnë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimit Social Shtetëror, Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë i nivelit të parë dhe Epror, si dhe komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të nivelit të parë dhe të dytë, që funksionojnë pranë Shërbimit Social Shtetëror, të cilat kanë qenë të pezulluara për shkak të epidemisë COVID-19, nisin funksionimin e tyre, duke respektuar masat për parandalimin e përhapjes së infeksionit, sipas përcaktimeve në këtë urdhër. 2. Afatet e parashikuara sipas rregulloreve të Shërbimit Social Shtetëror dhe Institutit të

Sigurimeve Shoqërore të mos aplikohen për periudhën e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë, COVID-19.

Urdhri nr. 226, datë 2.4.2020, shfuqizohet.

Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Shërbimi Social Shtetëror, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës të nivelit të parë dhe epror.

Urdhërin e plotë e gjeni në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/09/01/266-1/477d2791-f966-4c8a-957c-0555436c6de2>

VENDIM - Nr. 783, datë 7.10.2020

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT 2020–2022, NË ZBATIM TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR DECENTRALIZIMIN DHE QEVERISJEN VENDORE, 2015–2020

Plani i Veprimit i aprovuar përfshin: A. Konsolidimin e kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore; B. Forcimin e financave vendore dhe autonomisë fiskale; C. Nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm

vendor; D. Forcimin e qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Planin e plotë të veprimit e gjeni në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/10/07/783/303f90b3-e483-446d-8ed1-a117d84f9a2f>

VENDIM - Nr. 798, datë 12.10.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 17, DATË 15.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT, FORMIMIT NË PUNË DHE PRAKTIKAVE PROFESIONALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave vendosi që në pikën 4, të kreut II, të vendimit nr. 17, datë 15.1.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a Në shkronjën “a”, fjalët “... shoqëri tregtare të regjistruara ...” zëvendësohen me “... persona fizikë apo juridikë të regjistruar ...”.
- b Në shkronjën “e”, fjalët “... shoqëri tregtare ...” zëvendësohen me “... persona fizikë apo juridikë ...”.

Vendimin e gjeni në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/10/12/798/f8513130-2e13-48f3-ac92-f9cc099e824e>

URDHËR - Nr. 577, datë 14.10.2020

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË URDHRIN NR. 266/1, DATË 1.9.2020, PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NGA KOMISIONET E VLERËSIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE INVALIDËVE TË PUNËS PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Në mbështetje të nenit 116, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri”, si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, ky urdhër riformulon pikën 2 të urdhrin nr. 266/1, datë 01.09.2020, i ndryshuar, si vijon: “2. Tejkalmi i afateve të vlerësimit/rivlerësimit të aftësisë së kufizuar, gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, të përcaktuar në vendimin nr. 182, datë 26.2.2020, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës

personal”, të ndryshuar, nuk përbën shkak për ndërprerjen e pagesave të aftësisë së kufizuar”, për përfituesit të cilëve iu ka përfunduar afati i përfitimit sipas vendimit të komisionit. Trajtimi me pagesë bëhet deri në momentin e rikomisionimit të tyre”. Pas pikës 7, të urdhrin nr. 266/1, datë 1.9.2020, të ndryshuar, shtohen pikat 7.1 dhe 7.2 me këtë përmbajtje: “7.1 Përjashtimisht, gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 paraqitja e personave në komisionin e nivelit të parë, sipas pikave 1.1 dhe 1.2, të kreut II, të vendimit nr. 182, datë 26.2.2020, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”, të ndryshuar, pikave 2.1 dhe 2.2, të udhëzimit nr. 2365, datë 26.11.2008, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar, realizohet me komisionin, personalisht përmes platformave online dhe në prani të përfaqësuesit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (mjek), në vendbanimin e personit. 7.2 Paraqitja në KMCAP-në eprore bëhet me prezencën

fizike të personit. Vetëm në raste të veçanta, kur gjendja shëndetësore e rënduar është e argumentuar nga mjeku specialist përkatës, së bashku me arsyen e pamundësisë së paraqitjes në komision, si edhe kur KMCAP-ja eprorë gjykon që paraqitja fizike është e pamundur, procedura e vlerësimit bëhet përmes platformave

online, në prezencë të përfaqësuesit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (mjek) ose me prezencën e anëtarit/ve të komisionit epror, në vendbanimin e personit.”.

Urdhërin e gjeni në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/10/14/577/97523012-d402-440f-9f90-dc3941d7d10c>

VENDIM - Nr. 837, datë 28.10.2020

PËR PROCEDURAT, KRITERET E RREGULLAT PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT

Ky vendim, i dalë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, përcakton procedurat, kriteret e rregullat për ofrimin e shërbimeve të punësimit ndaj punëkërkuessve dhe punëdhënësve, që janë të regjistruar në zyrën përkatëse të punësimit në Republikën e Shqipërisë, për të përfituar nga këto

shërbime. Shërbimet e punësimit ofrohen nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (në vijim, AKPA) nëpërmjet strukturave të varësisë.

Lexoni të plotë vendimin në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/10/28/837/d3e2cbd4-94bd-4b2a-b9a3-f507c46ee9c7>;

LIGJ - Nr. 124/2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10221, DATË 4.2.2010, “PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, shtesat dhe ndryshimet bëjnë të mundur që ligji të ofrojë mekanizma ligjore për qytetarët, për promovimin e barazisë dhe mos diskriminimin, edhe për disa shkaqe të reja, siç janë: Shkak Diskriminimi për “Shtetësinë”, “Hiv Aids”, “Karakteristikat e seksit” në dallimin mes gjinisë/seksit. Ligji është i plotë me format e reja të diskriminimit siç është “Diskriminimi

i shumëfishtë”, “Shqetësimi seksual”, “Gjuha e urrejtjes”, “Segregimi”, “Diskriminimi i strukturuar”. Për herë të parë në këtë ligj sanksionohet që të gjitha organet publike duhet të jetë të përfshira në promovimin e barazisë.

Të plotë VKM-në me ndryshime e gjeni në: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/10/15/124/c6d5d6ef-dbcc-45a0-beb0-5eff962b4546>

LIGJ - Nr. 125/2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9669, DATË 18.12.2006, “PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” bëhen shtesa dhe ndryshime: Në nenin 1, pika 2 riformulohet si vijon: “2. Garantimin

e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, subjekt i

këtij ligji, sipas nenit 3 të tij.”. Në nenin 3, pika 3 riformulohet: “3. “Dhunues” është çdo person i dyshuar dhe/ose i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.”. Në nenin 10 bëhen këto ndryshime: a) Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si vijon: “1. Gjykata, si masë mbrojtëse të dhunës në familje, urdhëron menjëherë largimin e dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktimë dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë. Gjykata, kur është rasti, në vendosjen

e kësaj mase merr në konsideratë nevojat e veçanta të dhunuesit të mitur, të moshuar ose personit me aftësi të kufizuara dhe në këto raste urdhri i largimit nga banesa vendoset vetëm kur asnjë masë tjetër nuk garanton mbrojtjen e viktimës nga dhuna. Përveç masës së largimit të dhunuesit nga banesa, mbrojtja ndaj dhunës në familje, në zbatim të këtij ligji, sigurohet dhe në këto mënyra:”.

Ndryshimet e plota i gjeni në: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/10/15/125/ca8b14a0-12a5-42c4-a03a-b93443ffdd03>

Ky grant është mundësuar nga ‘Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën’, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja e paraqitur nuk përfaqëson qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).



Norwegian Embassy

